VENDIM
Nr. 42, datë 19.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Elsa Toska	anëtare
Sonila Bejtja	anëtare
Sandër Beci	anëtar
Genti Ibrahimi	anëtar
Marjana Semini	anëtare
Ilir Toska	anëtar

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleks Lici, Lefteria Lici

SUBJEKT I INTERESUAR: Telemah Rajdho

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 33, 42, 43, 116, 122, 124, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" e 2, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta)*; nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Telemah Rajdho, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Aleks Lici dhe Lefteria Lici janë bashkëshortë. Kjo e fundit është motra e subjektit të interesuar, Telemah Rajdho. Sipas kontratës së shitjes nr. 2035 rep., dhe nr. 881 kol., datë 9.10.2000 *(kontrata e shitjes së truallit),* kërkuesit dhe subjekti i interesuar kanë blerë nga këshilli i qarkut Gjirokastër (seksioni i financës) truallin me sipërfaqe 1380 m^2, të ndodhur në Gjirokastër. Më herët, Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë këshillit të qarkut Gjirokastër (*KRRT-ja, Gjirokastër*), me vendimin nr. 15, datë 13.4.1993, ka miratuar sheshin e ndërtimit për këtë truall dhe, më pas, me vendimin nr. 14, datë 8.4.1998, ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit për objektin "lokal dhe banesë". Në vijim, me vendimin nr. 1, datë 24.7.2003, KRRT-ja, Gjirokastër ka miratuar sheshin dhe lejen e ndërtimit për objektin "shtesë anësore lokali e banese në të dyja krahët në pronë të vet". Pas ndërtimit të objektit dhe shtesave anësore mes kërkuesve dhe subjektit të interesuar kanë lindur mosmarrëveshje për pronësinë e truallit dhe të objektit të

ndërtuar mbi të, që posedoheshin nga kërkuesit, të cilët pretendonin se ishin pronarë të vetëm të kësaj pasurie.

2. Në lidhje me këtë mosmarrëveshje, subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor civil, ku me padinë e paraqitur ka kërkuar detyrimin e kërkuesve për ta njohur bashkëpronar të pasurisë (truall dhe ndërtesë) për 1/2-ën pjesë *(procesi i themelit të bashkëpronësisë).* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 2209, datë 15.12.2008, ka vendosur pranimin e padisë dhe njohur të drejtën e bashkëpronësisë subjektit të interesuar dhe kërkuesve për një objekt 4-katësh dhe të truallit prej 1380 m^2 ku ai është ndërtuar, me nga 1/3-ën pjesë secili. Gjykata ka pranuar se në vitin 1993 palët kanë rënë dakord të ndërtonin një objekt 4-katësh, ku mbi këtë bazë, me kërkesën e tyre është miratuar sheshi i ndërtimit dhe më pas edhe leja e ndërtimit, ku përcaktohet se investitorë janë palët në proces, ndërkohë që në vitin 2000 ata kanë blerë nga shteti edhe truallin me sipërfaqe dhe kufij të përcaktuar. Objekti është ndërtuar me investimin e përbashkët të palëve dhe ai ka përfunduar. Referuar neneve 163 dhe 705 të Kodit Civil *(KC),* palët janë bërë pronarë të ligjshëm të pasurisë. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar edhe lidhur me vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës së kërkuesve për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin si prova të një akti ekspertimi grafik, për sa i përkiste nënshkrimit të subjektit të interesuar në kontratën e shitjes së truallit, si dhe të vendimit për lejen e ndërtimit të shtesës anësore. Sipas gjykatës, këto dokumente nuk plotësonin kriteret për t'u marrë në shqyrtim si prova dhe nuk kishin lidhje me objektin e padisë, ndërkohë që palët i kishin pasur të gjitha mundësitë për të vërtetuar falsitetin e shkresave. Gjykata ka vërejtur se falsiteti i kontratës së shitjes së truallit nuk ishte pretenduar asnjëherë më parë nga kërkuesit, ndërkohë që ekspertimi privat shërbente si dyshim i arsyeshëm, por nuk mund të merrej si provë nga gjykata. Sipas saj, konkluzioni i ekspertit nuk tregonte se dokumenti ishte i falsifikuar, pasi varej nga dokumenti me të cilin ai kishte bërë krahasimin.

3. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, pas ankimit të tij nga të dyja palët ndërgjyqëse, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009. Sipas asaj gjykate, nga tërësia e provave të administruara provohet se mes palëve, që janë në marrëdhënie të posaçme, ka ekzistuar qëllimi i përbashkët për krijimin e një sendi në bashkëpronësi me kontributin e tyre të përbashkët, i cili dhe u realizua. Dokumentacioni ligjor për ndërtimin e objektit dhe kontrata e shitjes së truallit rezultonte në emër të të tre ndërgjyqësve, por edhe ndërtimi i shtesës, pavarësisht se ishte vetëm në emër të kërkuesit Aleks Lici, përveç marrëdhënies së posaçme mes palëve, duke qenë një ndërtim në funksion të të parit dhe në truallin në bashkëpronësi të të tre ndërgjyqësve, bazuar në nenet 173 e 175 të KC-së, i përkasin pronarit të truallit, pra të të tre ndërgjyqësve në bashkëpronësi. Ndër të tjera, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur në ankimin e kërkuesit për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, për sa i përkiste subjektit të interesuar, duke arsyetuar se një gjë e tillë nuk ishte kundërshtuar gjyqësisht sipas rregullave procedurale.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuesit dhe subjekti i interesuar.

5. Në datën 15.12.2011, bazuar në nenet 494 e vijuese të KPC-së, kërkuesit kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë, me objekt: *"Rishikim i vendimit civil nr. 2209, datë 15.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, vendosur mospranimi i rekursit në dhomën e këshillimit me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë" (kërkesa fillestare për rishikim).* Si shkak për rishikimin e vendimit të procesit të themelit të bashkëpronësisë, kërkuesit kanë parashtruar: i. zbulimin e rrethanave të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj (neni 494, shkronja "a", i KPC-së), ku për këtë shkak rishikimi ata kanë paraqitur si provë shkresën nr. 2598 prot., datë 30.11.2011 të Bashkisë Gjirokastër *(shkresa e Bashkisë Gjirokastër, nëntor 2011)*, sipas së cilës "Objekti aktualisht është ndërtuar me tre kate, nga katër kate të miratuara sipas projektit", çka, sipas kërkuesve, tregonte se vendimi objekt kërkese për rishikim ishte i gabuar pasi ata janë detyruar të njohin subjektin e

interesuar si bashkëpronar për një objekt 4-katësh; ii. vendimi ishte bazuar në dokumente të falsifikuara (neni 494, shkronja "ç", i KPC-së), ku për këtë shkak rishikimi ata kanë paraqitur si prova dy akte ekspertimi grafik nënshkrimi të datave 16 dhe 18 nëntor 2011 *(akte ekspertimi grafik nënshkrimi, nëntor 2011)*, bërë me kërkesën e tyre, akte sipas të cilëve nënshkrimi i subjektit të interesuar Telemah Rajdho në kontratën e shitjes së truallit dhe në dokumentin akt vlerësimi datë 29.9.2000, nuk ishte nënshkrimi origjinal i tij, çka, sipas kërkuesve, ishte një rrethanë e re që kishte rëndësi për çështjen dhe që nuk dihej prej tyre kur ajo ishte gjykuar, ndërsa tregonte se vendimi objekt kërkese për rishikim ishte i gabuar.

6. Nga ana tjetër, kërkuesi Aleks Lici ka vënë në lëvizje disa procese gjyqësore, përmes të cilëve ka goditur vërtetësinë e dokumenteve të administruara si prova shkresore në procesin e themelit të bashkëpronësisë apo vlefshmërinë e veprimit juridik *(kontratës së shitjes së truallit)*. Ndër to është dhe procesi i vënë në lëvizje nga ai në datën 7.1.2012, me të paditur subjektin e interesuar Telemah Rajdho, kërkuesen Lefteria Lici dhe këshillin e qarkut Gjirokastër, në të cilin ka kërkuar njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak falsiteti të kontratës së shitjes së truallit, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar dhe të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000 (*akti i vlerësimit*), pjesë e dokumentacionit shoqërues të kontratës së shitjes së truallit, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar, si dhe papërdorshmërinë e atij dokumenti *(procesi i lidhur)*.

7. Në përfundim të procesit të lidhur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së kërkuesit, duke shpallur si të falsifikuar kontratën e shitjes së truallit dhe aktin e vlerësimit. Ndërkohë ajo ka rrëzuar kërkimin e padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, si kërkim i gjykuar më parë me vendim përfundimtar, midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin shkak ligjor. Mbi ankimin e kërkuesit dhe të subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pjesën e pranuar, duke shpallur pjesërisht të falsifikuar kontratën e shitjes së truallit dhe aktin e vlerësimit, datë 29.9.2000, në rekuizitën "blerësi" për pjesën që pasqyron emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e subjektit të interesuar Telemah Rajdho, si dhe duke urdhëruar mospërdorimin e këtyre dokumenteve për pasojat që rrjedhin nga kjo pjesë e falsifikuar e tyre. Nga ana tjetër, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për pjesën e rrëzuar të padisë, është prishur dhe gjykimi i çështjes për këtë pjesë është pushuar. Vendimi i gjykatës së apelit është prishur më pas dhe çështja i është kthyer asaj për rishqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2016-2895 (261), datë 9.11.2016.

8. Pas rigjykimit të çështjes në procesin e lidhur, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për të gjitha disponimet e tij, përveç atij për kërkimin e falsitetit të aktit të vlerësimit dhe pasojave të këtij falsiteti, për të cilin ka vendosur rrëzimin e tij. Mbi rekurset e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta për pjesën e pranuar të padisë, duke vendosur rrëzimin e saj. Ndërkohë vendimi i gjykatës së apelit për pjesën e rrëzuar të padisë është lënë në fuqi. Me këtë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, praktikisht padia e kërkuesit Aleks Lici është rrëzuar në tërësi.

9. Ndërkohë që kërkesa për rishikim ndodhej në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, në datën 29.4.2013 kërkuesit kanë parashtruar një shtesë kërkese për rishikim, me të cilën në funksion të shkakut të pretenduar të rishikimit, sipas nenit 494, shkronja "ç", të KPC-së, ata kanë referuar tashmë se vendimi i procesit të themelit të bashkëpronësisë ishte bazuar në dokumente të falsifikuara, e vërtetuar kjo me vendim civil të formës së prerë, konkretisht me vendimin e gjykatës së apelit të marrë në gjykimin për herë të parë në procesin e lidhur (vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër), sikurse kërkonte neni 495 i KPC-së *(shtesë kërkese për rishikim)*.

10. Kërkesa për rishikim dhe shtesa e saj është shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsyetimin se ajo nuk është e bazuar në ligj.

11. Në datën 7.7.2022 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual *(ankimi i parë kushtetues)*, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë *(vendimit në procesin e lidhur)*. Me vendimin nr. 28, datë 18.5.2023, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) e ka shfuqizuar atë vendim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim.

12. Ndërkohë, në datën 9.2.2023, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual *(ankimi i dytë kushtetues)*, për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022 *(vendimit për mospranimin e kërkesës për rishikim)*.

13. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 26.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 28.4.2023, ka vendosur pezullimin e afatit të shqyrtimit paraprak të ankimit të dytë kushtetues dhe zgjatjen e tij deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit të parë kushtetues të kërkuesve për procesin e lidhur, pasi ka vlerësuar se përfundimi më parë i shqyrtimit paraprak të ankimit të dytë kushtetues do të komplikonte dhe mund të paragjykonte shqyrtimin e ankimit të parë kushtetues të tyre.

14. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit të parë kushtetues dhe rënies në këtë mënyrë të shkakut të pezullimit të afatit, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vijuar me shqyrtimin paraprak të ankimit të dytë kushtetues të kërkuesve dhe me vendimin e datës 5.6.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Në datën 6.9.2023 avokatja e subjektit të interesuar ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 19.9.2023 dhe caktimin e një afati të arsyeshëm kohor për përgatitjen dhe paraqitjen e parashtrimeve dhe provave. Pavarësisht kësaj kërkese, në datën 13.9.2023 avokatja e subjektit të interesuar ka depozituar parashtrimet e saj. Në këto kushte, në datën 14.9.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur të mos e pranojë kërkesën.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

16.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj,* pasi deri në datën 1.4.2022 kërkesa për rishikim dhe procesi i lidhur kanë qenë për shqyrtim përpara të njëjtit trup gjykues në Gjykatën e Lartë, i cili ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim vetëm pas marrjes së vendimit përfundimtar në procesin e lidhur, ndërkohë që duhet të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i këtij të fundit. Trupi gjykues i dorëhequr ka lejuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh, qoftë në procesin e lidhur, ashtu edhe në shqyrtimin e kërkesës për rishikim. Në të dyja çështjet ndihmësja ligjore ka qenë e njëjta, ndërkohë që ajo duhej të kishte hequr dorë nga kërkesa për rishikim në zbatim të të njëjtave rregulla që KPC-ja parashikon për gjyqtarin. Vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues që dha dorëheqjen dhe përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga ndihmësja ligjore.

16.2. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuesit nuk janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit. Ata nuk janë njoftuar për seancat e datave 7.3.2022 dhe 6.6.2022 dhe as për ndryshimin e trupës gjyqësore si pasojë e dorëheqjes së trupës së mëparshme për t'u dhënë mundësinë të ushtronin, sipas rastit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin, ashtu edhe të drejtën për të parashtruar argumente të tjera mbrojtëse ose kërkesa procedurale. Kërkuesit nuk u njoftuan asnjëherë as për ndihmësen ligjore. Kërkesa për rishikim duhej të vijonte të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve, përveçse në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi nuk ka një praktikë të konsoliduar për sa i përket zbatimit të nenit 497 të këtij kodi lidhur me shqyrtimin e çështjes në themel, si dhe për sa i përket vlerësimit të faktit të një dokumenti të falsifikuar nga një vendim

civil dhe jo penal, në kuptim të nenit 495 të KPC-së. Zbatimi i dispozitës kalimtare që i jep të drejtë gjykatës të revokojë vendimet për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe t'i shqyrtojë ato në dhomën e këshillimit, përbën kufizim joproporcional dhe të palejuar nga Kushtetuta të aksesit efektiv në gjykatë. Edhe nëse ky kufizim do të ishte kushtetues, përsëri nuk ka kuptim të zbatohej për çështjet që janë tashmë në gjykim.

16.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet për revokimin e vendimit të shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe shkaqet për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit. Në vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim, ajo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesve, duke ngatërruar faktin juridik me provën shkresore që e vërteton ekzistencën e tij. Gjykata e Lartë nuk ka arritur të kuptojë qartë shkaqet e kërkesës për rishikim dhe ka keqcituar e keqlexuar provat shkresore në raport me faktet e tjera me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë, të gjykatës së apelit për herë të parë dhe në rigjykimin e procesit të lidhur, ka rezultuar se vendimi në procesin e themelit të bashkëpronësisë është mbështetur në dokumente të falsifikuara, si kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit, falsiteti i të cilëve është vërtetuar nga disa akte ekspertimi grafik të urdhëruara nga gjykata.

16.4. *Së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik* në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë që zbaton ligjin dhe Kushtetutën dhe jep vendim të bazuar në prova dhe fakte pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm, në respektim të parimit të disponibilitetit dhe së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me faktet dhe provat e reja që mbështesin pretendimet e kërkuesve, në veçanti provat që vërtetonin falsifikimin e kontratës së shitjes së truallit dhe të aktit të vlerësimit, prova këto që tregonin se përfundimi i gjykatave në procesin e themelit të bashkëpronësisë është i gabuar, ku e vetmja mënyrë për të rivendosur zbatimin e saktë të ligjit dhe për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor është pranimi i kërkesës për rishikim. Vendimi i Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ka parregullsi në data. Ajo gjykatë nuk e ka regjistruar audio seancën që ka zhvilluar për çështjen e kërkuesve, në shkelje të udhëzimit nr. 353/2013, përveçse edhe procesverbali me shkrim nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të KPC-së.

17. ***Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho,*** ka prapësuar si vijon:

17.1. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument ose provë në mbështetje të tij. Anëtarët e trupit gjykues janë emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin e posaçëm dhe nuk tregohet asnjë fakt që të përbëjë shkak për përjashtimin e gjyqtarit sipas nenit 72 të KPC-së ose që të provojë se ata nuk gëzojnë garancitë e nevojshme për paanshmëri, të kërkuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Këshilltarja ligjore i nënshtrohet rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesit sipas nenit 34 të ligjit nr. 98/2016 dhe për të nuk jepet asnjë argument ose provë që vërteton për qenien e saj në ndonjë nga këto situata. Këshilltari ligjor është nëpunës gjyqësor pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe nuk është i atashuar pranë një gjyqtari. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të paanshmërisë ose të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj në rastin e procesit të lidhur, nuk mund të jenë pjesë e këtij gjykimi, përveçse ato janë gjetur të pabazuara nga Gjykata me vendimin nr. 28/2023.

17.2. Pretendimi për *cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur* është i pabazuar, pasi përgjatë 10 vjetëve që procesi i rishikimit ka vazhduar, kërkuesit janë njoftuar rregullisht për ecurinë e tij, kanë marrë pjesë kur shqyrtimi është zhvilluar në prani të palëve, kanë paraqitur pa asnjë kufizim kërkesa dhe pretendime, duke pasur qasje të pakufizuar dhe njohje të plotë të të gjithë veprimtarisë procedurale të kryer nga Gjykata e Lartë. Vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të

shqyrtimit të çështjes. Kërkuesit janë njohur me vendimin për revokimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit, duke paraqitur mbrojtjen me shkrim në datën 15.11.2021. Ata nuk provojnë se si kjo vendimmarrje e Gjykatës së Lartë ka ndikuar në të drejtat e tyre procedurale, për më tepër kur gjykata e ka shqyrtuar në themel çështjen duke dalë me vendim përfundimtar.

17.3. Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi vendimi i revokimit është i arsyetuar dhe në të tregohen arsyet ligjore për shqyrtimin e kërkesës në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve (dhomë këshillimi) referuar ndryshimeve të bëra në KPC. Për sa i përket vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, si dhe me vlerësimin e provave prej saj, të cilat nuk janë pjesë e juridiksionit kushtetues. Ajo gjykatë i ka kthyer përgjigje në mënyrë të hollësishme dhe shteruese çdo pretendimi të parashtruar në kërkesën për rishikim, shtesën e kësaj kërkese dhe aktin e mbrojtjes së datës 15.11.2021.

17.4. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik* në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë që zbaton ligjin dhe Kushtetutën dhe jep vendim të bazuar në prova dhe fakte pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm, në respektim të parimit të disponibilitetit dhe të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, është i pabazuar, pasi argumentet në mbështetje të këtij pretendimi lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk janë të natyrës kushtetuese. Në procesin gjyqësor që kundërshtohet nuk konstatohen shkelje të natyrës kushtetuese si dhe as që zbatimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

18. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e kërkesës për rishikim, duke ngritur pretendime për disa aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për këto pretendime ata nuk kanë mjete të tjera ankimi, ndaj Gjykata çmon se plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

22. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) dhe qëndrimit të saj në çështjen *"Supergrav Albania" sh.p.k. kundër Shqipërisë (aplikimi nr. 20702/18, datë 9.5.2023)*, në drejtim të përcaktimit të momentit nga i cili fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor, Gjykata vlerëson se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, ndërsa atëherë kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit.

23. Duke zbatuar këtë qasje në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit, i marrë në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), i është njoftuar elektronikisht avokatit të kërkuesve në datën 12.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 9.2.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

24. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t'i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes *(shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, Gjykata konstaton se kërkuesit i kanë mbështetur argumentet e tyre në faktet se përgjatë një periudhe kohore kërkesa për rishikim dhe procesi i lidhur kanë qenë për shqyrtim përpara të njëjtit trup gjykues në Gjykatën e Lartë; se trupi gjykues që u dorëhoq nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim duhej të dorëhiqej nga shqyrtimi i procesit të lidhur; se trupi gjykues i dorëhequr ka lejuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh qoftë në procesin e lidhur, ashtu edhe në shqyrtimin e kërkesës për rishikim; se në të dyja çështjet ndihmësja ligjore ka qenë e njëjta, ndërkohë që ajo duhej të kishte hequr dorë nga kërkesa për rishikim; se vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues që u dorëhoq dhe përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga ndihmësja ligjore.

26. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit, për nga mënyra se si janë parashtruar ato, kanë të bëjnë, në thelb, me parimin e paanshmërisë në gjykim, në kuptim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj. Referuar këtyre pretendimeve, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë dhe të provojnë në nivel kushtetues pretendimin në lidhje me mungesën e elementeve subjektive dhe objektive, të cilat qëndrojnë në themel të parimit të paanshmërisë së gjykatës, në funksion të krijimit të besimit në dhënien e drejtësisë. Për më tepër, kërkuesit i kanë adresuar pretendimet e tyre në drejtim të gjyqtarëve (trupit gjykues) që ka dhënë dorëheqjen, të cilët nuk kanë qenë pjesë e vendimmarrjes, dhe jo ndaj atyre që kanë shqyrtuar çështjen dhe kanë dhënë vendimin e kundërshtuar për kërkesën për rishikim. Argumenti se vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues i dorëhequr apo se përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga këshilltarja ligjore, nuk ka asnjë bazë faktike dhe ligjore. Gjykata çmon se vetëm fakti se të njëjtët gjyqtarë ishin caktuar fillimisht si anëtarë të trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjet e kërkuesit nuk mjafton për konstatimin e cenimit të parimit të paanshmërisë, përderisa nuk ka një vendimmarrje ose vlerësim prej tyre për të dyja këto çështje.

27. Nga ana tjetër, edhe përpjekja për të barazuar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse të këshilltarit ligjor me atë vendimmarrëse të gjyqtarit të çështjes nuk gjen bazë ligjore dhe kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë se në çfarë mënyre ka ndikuar kjo veprimtari në atë vendimmarrëse të gjykatës, në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes, ndërkohë që nuk përcaktojnë asnjë detyrim të asaj gjykate apo edhe të drejtë të palëve për t'u njohur me të apo për t'iu komunikuar aktet që ai prodhon në ushtrim të kësaj veprimtarie ndihmëse dhe këshilluese.

28. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, duke argumentuar, mes të tjerash, se Gjykata e Lartë ka gabuar lidhur me vlerësimin e provave të rishikimit dhe zbatimin e ligjit, ndërsa kërkesa për rishikim nuk duhej refuzuar, pasi nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë, të gjykatës së apelit për herë të parë dhe në rigjykimin e procesit të lidhur, ka rezultuar se vendimi në procesin e themelit të bashkëpronësisë është mbështetur në dokumente të falsifikuara, si kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit, falsiteti i të cilave është vërtetuar nga disa akte ekspertimi grafik të urdhëruara nga gjykata.

29. Po kështu, sipas kërkuesve, është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe publik, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me faktet dhe provat e reja që mbështesin pretendimet e kërkuesve, në veçanti provat që vërtetonin falsifikimin e kontratës së shitjes së truallit dhe të aktit të vlerësimit, të cilat tregonin se përfundimi i gjykatave në procesin e themelit të bashkëpronësisë ishte i gabuar. Ndaj e vetmja mënyrë për të rivendosur zbatimin e saktë të ligjit dhe për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor është pranimi i kërkesës për rishikim. Ata kanë pretenduar, gjithashtu, se vendimi i Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ka parregullsi në data dhe se Gjykata e Lartë nuk e ka regjistruar audio seancën në dhomë këshillimi, në shkelje të udhëzimit nr. 353/2013, si dhe procesverbali me shkrim nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të KPC-së.

30. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve, si më sipër, kanë të bëjnë, në thelb, me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit, ndërkohë që ata nuk kanë arritur t'i ngrenë ato në nivel kushtetues, pra të provojnë cenimin e ardhur në të drejtat e tyre kushtetuese nga kjo veprimtari. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të konsoliduar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyn kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2,*

datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, kërkuesit nuk e plotësojnë kriterin e legjitimimit *ratione materiae* në lidhje me pretendimet si më sipër.

31. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit, ato janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj bazueshmëria e tyre në themel do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

32. Kërkuesit kanë pretenduar se nuk janë njoftuar për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit për seancat e datave 7.3.2022 dhe 6.6.2022 dhe as për ndryshimin e trupës gjyqësore si pasojë e dorëheqjes së trupës së mëparshme, për t'u dhënë mundësinë të ushtronin, sipas rastit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin, ashtu edhe të drejtën për të parashtruar argumente të tjera mbrojtëse ose kërkesa procedurale. Kërkesa për rishikim duhet të vijonte të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve, përveçse në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi nuk ka një praktikë të konsoliduar për sa i përket zbatimit të nenit 497 të këtij kodi lidhur me shqyrtimin e çështjes në themel, si dhe për sa i përket vlerësimit të faktit të një dokumenti të falsifikuar nga një vendim civil dhe jo penal në kuptim të nenit 495 të KPC-së. Zbatimi i dispozitës kalimtare që i jep të drejtë gjykatës të revokojë vendimet për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore përbën kufizim jo proporcional dhe të palejuar nga Kushtetuta të aksesit efektiv në gjykatë. Edhe nëse ky kufizim do të ishte kushtetues, nuk ka kuptim që ai të zbatohej për çështjet tashmë në gjykim.

33. Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka prapësuar se përgjatë 10 vjetëve që ka vijuar procesi i rishikimit, kërkuesit janë njoftuar rregullisht për ecurinë e tij, kanë marrë pjesë kur shqyrtimi është zhvilluar në prani të palëve, si dhe kanë paraqitur kërkesa dhe pretendime, duke pasur qasje të pakufizuar dhe njohje të plotë të të gjithë veprimtarisë procedurale të kryer nga Gjykata e Lartë. Vetëm fakti i shqyrtimit të kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me rregullat e reja procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes. Kërkuesit janë njohur me vendimin për revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe kanë paraqitur mbrojtje me shkrim në datën 15.11.2021, dhe ata nuk provojnë se si kjo vendimmarrje e Gjykatës së Lartë ka ndikuar në të drejtat e tyre procedurale, për më tepër kur gjykata e ka shqyrtuar në themel çështjen, duke dalë me vendim përfundimtar.

34. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ngrihen në dy drejtime: së pari, për mosnjoftimin nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomë këshillimi dhe për përbërjen e trupit gjykues; së dyti, për formën e gjykimit të ndjekur nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, pra për shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh dhe jo në seancë dëgjimore.

35. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i

njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Ajo ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 37, datë 30.6.2016; nr. 31, datë 26.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese)*. Po kështu, gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson. Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Lidhur me njoftimin për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se në nenin 497, pika 1, që i përket titullit të tretë të pjesës së tretë të KPC-së, që rregullon institutin e rishikimit, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, parashikohet se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Ndërkohë, në titullin e dytë të kësaj pjesë, KPC-ja rregullon rekursin në Gjykatën e Lartë, ku në nenin 482, pika 3, parashikohet se sekretaria shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

38. Për sa i përket procedurës së shqyrtimit të çështjes (rekursit) në Gjykatën e Lartë, në pjesën e tretë, titullin e dytë, kreu II, KPC-ja parashikon dy forma gjykimi, atë në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh/seancë mbi dokumente (neni 482) dhe atë në seancë gjyqësore me praninë e palëve/seancë dëgjimore (neni 482/a). Dhoma e këshillimit/seanca mbi dokumente si formë gjykimi nga Gjykata e Lartë është e ndryshme nga dhoma e këshillimit që bën fjalë neni 480 i KPC-së, që rregullon fazën seleksionuese, pra verifikimin e kritereve të pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit, dy forma gjykimi këto të përcaktuara me ndryshimet e bëra KPC-së me ligjin nr. 44/2021.

39. Forma e gjykimit të kërkesës për rishikim nga Gjykata e Lartë, përpara ndryshimeve të KPC-së në vitin 2017, është bërë objekt kontrolli kushtetues dhe, më tej, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë ndryshuar praktikën gjyqësore përmes vendimit unifikues nr. 1, datë 31.1.2006. Në këtë vendim, ato kanë vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, precedentët e GJEDNJ-së dhe neni 447 i KPC-së (që rregullon njoftimin e ankimit për palët e tjera) i kanë garantuar kujtdo të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, në themel të të cilit qëndron dhënia e mundësive të barabarta secilës palë për ndjekjen dhe mbrojtjen e çështjes në gjykatë, duke i siguruar mundësitë për të parashtruar pretendimet e saj, në kushtet që nuk e vënë në gjendje më pak të favorshme se sa pala kundërshtare. Në raste të tilla standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive është shansi i barabartë për të qenë në një proces gjyqësor për të cilin gjyqfituesi është akoma nën përfytyrimin e një të drejte të fituar me vendim të formës së prerë. Mbi këtë bazë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimet unifikuese se: *a)* shqyrtimi në dhomë këshillimi i kërkesës për rishikim konsiderohet shqyrtim paraprak i çështjes dhe jo seancë dëgjimore. Në këtë shqyrtim vendoset mospranimi i kërkesës për rishikim nëse nuk përmbushen kriteret ligjore për t'i "hapur rrugën" rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, pa cenuar kështu vendimin që ka zgjidhur përfundimisht çështjen; *b)*

në të kundërt, kur në dhomën e këshillimit konstatohet se faktet e paraqitura nga pala kërkuese mund të jenë shkaqe nga ato që ligji lejon rishikimin e një vendimi të formës së prerë, çështja duhet të kalojë në seancë të hapur gjyqësore për vlerësimin e shkaqeve të rishikimit. Gjykimi në seancë gjyqësore nuk është gjykim themeli, por një seancë dëgjimore ku secila nga palët pjesëmarrëse në gjykim, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, paraqet argumentet e veta.

40. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, konstaton se procesi i rishikimit është vënë në lëvizje me kërkesën e kërkuesve të datës 15.12.2011, si pala gjyqhumbëse në procesin gjyqësor të themelit. Gjatë kohës kur kërkesa për rishikim ka qenë në pritje për t'u shqyrtuar, kërkuesit kanë parashtruar një shtesë kërkese për rishikim në datën 29.4.2013. Kërkesa për rishikim dhe shtesa e saj janë marrë në shqyrtim paraprak nga Gjykata e Lartë, kolegji seleksionues i saj, i cili, pasi ka vlerësuar se ajo plotësonte kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim, me vendimin e datës 26.2.2014, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore *(vendimi i kolegjit seleksionues)*.

41. Në vijim, Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën për rishikim dhe në seancën e datës 17.6.2015, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, pasi ka konstatuar se në Gjykatën e Lartë ndodhej për shqyrtim edhe procesi i lidhur (pas rigjykimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Gjirokastër), ai ka vënë në diskutim kryesisht lidhjen dhe ndërvarësinë e këtij procesi (procesit të lidhur) me atë të kërkesës për rishikim dhe bazuar në nenin 297, shkronja "a", të KPC-së, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim deri në zgjidhjen nga ajo gjykatë të çështjes që i përkiste procesit të lidhur. Pas rënies së shkakut të pezullimit, në datën 25.5.2017 ka rifilluar shqyrtimi i kërkesës, por ai nuk është bërë për arsye objektive (mosformimin e trupit gjykues). Vetëm pas fillimit të funksionimit të Gjykatës së Lartë është bërë i mundur shqyrtimi i kësaj çështjeje. Me vendimin e datës 27.10.2021, trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e saj ka vendosur revokimin e vendimit të kolegjit seleksionues dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh *(vendimi i revokimit)*. Me këtë vendim është caktuar edhe data e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi më 20.12.2021, si dhe është urdhëruar sekretaria gjyqësore për të bërë njoftimin e palëve, duke i ftuar ato për të paraqitur parashtrime me shkrim brenda 15 ditëve nga njoftimi. Ky vendim u është njoftuar rregullisht kërkuesve.

42. Në datën 15.11.2021 avokati i kërkuesve ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim vendimi deri në përfundim të zgjidhjes nga Gjykata e Lartë të çështjes që i përket procesit të lidhur, duke i bashkëlidhur vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe rekursin e paraqitur nga kërkuesit kundër atij vendimi. Po në të njëjtën datë, me një akt të veçantë, ai ka paraqitur para Gjykatës së Lartë edhe mbrojtjen e kërkuesve në lidhje me kërkesën për rishikim. Në aktin e mbrojtjes, avokati i kërkuesve ka parashtruar se në hipotezën e mospranimit të kërkesës për pezullimin e gjykimit, kërkohej revokimi i vendimit të revokimit dhe shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Krahas kësaj, në hipotezën e mospranimit edhe të kësaj kërkese, avokati i kërkuesve ka parashtruar argumentet për bazueshmërinë e kërkesës për rishikimin, duke i kërkuar gjykatës që në përfundim të shqyrtimit të vendoste pranimin e saj.

43. Ndërkohë, Gjykata konstaton se trupi gjykues përkatës nuk ka disponuar me vendim për pranimin ose jo të kërkesave të avokatit të kërkuesve. Pavarësisht kësaj, kërkesa për rishikim nuk është shqyrtuar në datën e planifikuar. Gjykata e Lartë, përmes njoftimit të datës 20.12.2021, të publikuar në faqen zyrtare të saj, ka bërë të ditur se çështjet civile të shpallura për shqyrtim në dhomën e këshillimit në atë datë shtyhen dhe do të shqyrtohen në një datë tjetër, ku në listën e çështjeve bashkëlidhur atij njoftimi, është pasqyruar edhe kërkesa për rishikim e kërkuesve. Në dhomën e këshillimit të datës 7.3.2022, anëtarët e trupit gjykues kanë deklaruar heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim, mbi shkakun se kishin dhënë vendim në një çështje tjetër, pikërisht vendimin e datës 7.3.2022 në procesin e lidhur. Dorëheqja e tyre është pranuar me vendimin nr. 102 prot., datë 1.4.2022, të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

44. Kërkesa për rishikim është rindarë me short, përmes të cilit është caktuar relatori i çështjes dhe sipas procesverbalit të datës 4.4.2022, trupi gjykues është plotësuar me 2 anëtarë të tjerë, të cilët, referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton të jenë përfshirë në përbërjen e 2 trupave gjykues të përhershëm të Kolegjit Civil me vendimin nr. 8, datë 25.3.2022 të Këshillit të kësaj gjykate. Në datën 13.5.2022, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar njoftimi i trupit të ri gjykues për shqyrtimin e kërkesës për rishikim të kërkuesve në dhomën e këshillimit të datës 6.6.2022. Në këtë datë kërkesa për rishikim është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, ku është verifikuar njoftimi publik i palëve dhe është konstatuar mosparaqitja prej tyre e ndonjë kërkese procedurale. Në përfundim të shqyrtimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim. Po në datën 6.6.2022, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar njoftimi për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim të kërkuesve në dhomën e këshillimit të asaj date, krahas pjesës urdhëruese të vendimit të marrë.

45. Për sa më sipër, referuar këtyre fakteve me natyrë kushtetuese, Gjykata vëren se kërkuesit janë njoftuar rregullisht për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, përmes njoftimit të vendimit të revokimit, fakt që pranohet edhe nga vetë ata. Pas këtij njoftimi ata kanë paraqitur kërkesa procedurale, sikundër kanë parashtruar edhe argumente të tjera mbrojtëse në vijim të atyre të parashtruara në kërkesën për rishikim dhe shtesën e saj. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i kërkesës për rishikim jo në datën e planifikuar, për të cilën ata janë njoftuar, por në një datë tjetër të mëvonshme, nuk duket t'u ketë cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, për sa kohë atyre u janë garantuar këto të drejta, duke iu mundësuar të paraqesin kërkesa procedurale, sikundër edhe argumente të tjera në funksion të kërkesës së tyre për rishikim. Nga ana tjetër, ata jo vetëm kanë ushtruar të drejtën për të kërkuar rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, por edhe kanë marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për këtë kërkim të tyre. Nga kërkuesit nuk parashtrohet ndonjë argument konkret në këtë drejtim.

46. Megjithatë, Gjykata vëren se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk është bërë nga ai trup gjykues për të cilin kërkuesit janë njoftuar fillimisht. Një rrethanë e tillë bënte të nevojshëm njoftimin e palëve për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit të datës 6.6.2022 në funksion të bërjes të njohur edhe të përbërjes së trupit gjykues, për sa kohë ata gëzonin të drejtën procedurale për të kërkuar përjashtimin e ndonjë gjyqtari të veçantë ose të të gjithë trupit gjykues. Për këtë seancë në dhomën e këshillimit palët janë njoftuar me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj zyrtare. Megjithatë, avokati i kërkuesve nuk është njoftuar elektronikisht, pavarësisht se ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Gjithsesi, vetëm kjo mangësi në njoftim nuk duket t'i ketë vendosur kërkuesit në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së aksesit, në kuptimin substancial të saj, ndaj nuk është e mjaftueshme që ta bëjë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të kundërshtuar.

47. Në funksion të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, kërkuesit nuk kanë parashtruar ndonjë argument konkret për ekzistencën e ndonjë rrethane ose fakti që u jepte shkas të kërkonin përjashtimin e ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues, ndaj ky pretendim mbetet me natyrë të përgjithshme dhe abstrakte.

48. Për sa i përket pretendimit të kërkuesve se kërkesa për rishikim duhet të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve me argumentet se kështu gjykata kishte vendosur më herët apo se në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për zhvillimin e gjykimit në këtë formë, Gjykata vëren se argumentet për këtë pretendim kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural nga Gjykata e Lartë, çka është një çështje që i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe jo juridiksionit kushtetues. Ndërkohë, kërkuesit nuk argumentojnë se si kjo mënyrë e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit. Gjykata vlerëson të theksojë se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave

kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).* Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata vlerëson se nuk ka bazë të mjaftueshme për të konsideruar si arbitrar ose haptazi të paarsyeshëm interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për sa i përket formës së gjykimit të ndjekur ose si të padrejtë gjykimin e zhvilluar prej saj, për më tepër kur për kërkuesit nuk evidentohet ardhja e ndonjë pasoje për të drejtën kushtetuese të pretenduar si të cenuar.

49. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë me të drejtë ka konsideruar se vendimi i saj nr. 79, datë 7.3.2022 përbën vendim gjyqësor të formës së prerë, në kuptim të neneve 494, shkronja "ç" dhe 495 të KPC-së, për qëllimet e procedurës së rishikimit në rastin konkret. Duket se një mënyrë e tillë interpretimi afekton edhe rregullin në nenin 496 të KPC-së, sipas të cilit në rastet e parashikuara nga neni 495, afati i paraqitjes së kërkesës për rishikim fillon ditën që vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në çështjen konkrete, kërkuesit kanë paraqitur kërkesën për rishikim (shtesën), duke konsideruar si vendim të formës së prerë atë të gjykatës së apelit për herë të parë në procesin e lidhur (vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër), kërkesë e cila mbeti e pashqyrtuar nga Gjykata e Lartë për disa vjet, derisa kjo e fundit u shpreh në atë proces me vendimin përfundimtar nr. 79, datë 7.3.2022. Në këtë situatë dhe në këndvështrim të së drejtës kushtetuese për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, edhe pse në gjykimin kushtetues nuk janë ngritur pretendime në këtë drejtim, Gjykata evidenton se Gjykatës së Lartë, në ushtrim të kompetencës si gjykatë e ligjit, i përket detyra për të vlerësuar nëse ka vend për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me konceptin "vendim i formës së prerë" në dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e rishikimit.

50. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, për shkak të mosnjoftimit të seancës në dhomën e këshillimit, është i pabazuar. Kërkuesit nuk rezulton të jenë vendosur në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive ose me gjykimin e çështjes në tërësi, por ata e kanë ushtruar efektivisht të drejtën për të kërkuar rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, duke marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për këtë kërkim të tyre.

51. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në tërësi argumentet e kërkuesve për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, janë të pabazuara, ndaj i tillë gjendet edhe ky pretendim.

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

52. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet për revokimin e vendimit të shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe shkaqet për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit dhe se në vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre.

53. Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimi i revokimit është i arsyetuar dhe në të tregohen arsyet ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore pa praninë e palëve, mbi bazë dokumentesh, referuar ndryshimeve të bëra së fundi në KPC. Kurse për sa i përket vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë për kërkesën për rishikim, kërkuesit nuk parashtrojnë asnjë pretendim ose shpjegim ku të argumentohet mungesa nga ana ligjore e arsyetimit të vendimit në drejtim të mosdhënies përgjigje nga gjykata për të gjitha pretendimet e paraqitura nga ata. Ajo gjykatë i ka kthyer përgjigje në mënyrë të hollësishme dhe shteruese çdo pretendimi të parashtruar në kërkesën për rishikim, shtesën e kësaj kërkese dhe aktin e mbrojtjes të datës 15.11.2021.

54. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142/1 të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato

janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

55. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

56. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se ajo i shqyrton pretendimet për vendimin e revokimit të vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në këndvështrim të pretendimeve për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në tërësinë e tij, duke vlerësuar nëse ai ka qenë i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt.

57. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2021, ka vendosur revokimin e vendimit të kolegjit seleksionues për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe ka kthyer çështjen për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh. Kolegji Civil ka arsyetuar se pas ndryshimeve të legjislacionit procedural civil, të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2021, neni 482, pika 1, i KPC-së ka përcaktuar se shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, përveç rasteve të parashikuar në nenin 482/a të KPC-së. Po kështu, dispozitat tranzitore sipas ligjeve nr. 44/2021, nr. 49/2021 dhe nr. 41/2021 detyrojnë Gjykatën e Lartë të zbatojë rregullat e reja të gjykimit dhe, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me ritin e gjykimit të çështjeve në dhomën e këshillimit dhe me formimin e trupit gjykues. Në këto kushte, për çështjet për të cilat më parë është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, do të vlerësohet nëse shkaku i një vendimmarrjeje të tillë ka qenë nevoja për dëgjimin e palëve apo ato mund të shqyrtohen mbi bazë dokumentesh. Në rastin konkret, çështja është e tillë që mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, mbi bazën e akteve, duke iu dhënë mundësia atyre të realizojnë mbrojtjen e interesave të veta, në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, përmes paraqitjes së parashtrimeve me shkrim. Trupi i ri gjykues, i formuar pas dorëheqjes të trupit të mëparshëm, ka vlerësuar se kërkesa për rishikim duhet të vijonte të shqyrtohej në dhomën e këshillimit, duke bërë njoftimin përkatës.

58. Lidhur me vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka përshkruar pretendimet e kërkuesve të parashtruara në kërkesën fillestare dhe në atë shtesë, sikundër edhe provat e paraqitura nga ata. Po kështu, ai ka përshkruar faktet në lidhje me procesin e themelit të bashkëpronësisë dhe atë të procesit të lidhur dhe, më tej, ka përshkruar edhe vlerësimin e tij lidhur me bazueshmërinë në themel të kërkesës për rishikim për secilin nga shkaqet e ngritura nga kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ajo nuk është e bazuar në ligj.

59. Lidhur me kërkesën fillestare për rishikimin e vendimit (datë 15.12.2011), për sa i përket shkakut të parë të pretenduar të rishikimit, Kolegji Civil ka arsyetuar se dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesit, shkresa e Bashkisë Gjirokastër, nëntor 2011 dhe aktet e ekspertimit grafik, nënshkrimi nëntor 2011, ka vlerën e provës shkresore, në kuptim të nenit 494, shkronja

"a", të KPC-së, por se në këtë rast nuk plotësohen të gjitha kriteret ligjore që kjo dispozitë kërkon për rrethanat apo provat e reja me shkresë. Sipas tij, provat me shkresë të paraqitura tregonin për fakte dhe rrethana të njohura dhe të bëra të ditura gjykatës gjatë gjykimit të çështjes në themel, përveç se këto prova kërkuesit kanë pasur mundësi t'i siguronin gjatë gjykimit të çështjes dhe se ato nuk kanë rëndësi për zgjidhjen e saj *(shih paragrafët 24–27 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

60. Kurse lidhur me shtesën e kërkesës për rishikim (datë 29.4.2013), për sa i përket shkakut të dytë të pretenduar të rishikimit, Kolegji Civil ka arsyetuar se nuk qëndron pretendimi se vendimi objekt kërkese për rishikim është bazuar në dokumente të falsifikuara, konkretisht në kontratën e shitjes së truallit dhe në aktvlerësimin, falsitet ky i vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Sipas tij, ky i fundit rezulton të jetë prishur dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 79, datë 7.3.2022, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke mos u provuar kështu pretendimi për falsitet të dokumenteve i vërtetuar me një vendim gjyqësor sipas nenit 495 të KPC-së *(shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

61. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson të theksojë se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson kriteret e vendosura më sipër nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit. Ai përmban të dhënat e palëve, objektin e kërkesës dhe shkaqet e saj, provat e paraqitura në funksion të vërtetimit të shkaqeve të rishikimit dhe faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, si dhe analizën e tyre në raport me ligjin e zbatueshëm, që mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar i përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij.

62. Për sa më lart, në analizë të argumenteve të kërkuesve për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, Gjykata çmon se ai është i pabazuar.

63. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.9.2023.
Shpallur më 19.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesve Aleks Lici dhe Lefteria Lici, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues*", unë, gjyqtarja Marsida Xhaferllari bashkohem me shumicën për rrëzimin e kërkesës, por për shkak të ndryshëm që lidhet me mungesën e juridiksionit të Gjykatës për shqyrtimin e rastit konkret, arsye për të cilën edhe kam votuar në Mbledhjen e Gjyqtarëve kundër kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

2. Nga rrethanat e çështjes, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tyre për rishikimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare të datave 15.12.2008, 18.3.2009 dhe 14.1.2011 të dhëna përkatësisht nga gjykata e shkallës së parë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Lartë, me objekt njohjen e së drejtës së bashkëpronësisë mbi një pasuri të paluajtshme (truall dhe ndërtesë) në Gjirokastër. Ata kanë paraqitur si shkak për rishikim ekzistencën e provave të reja, që lidheshin me numrin e kateve të ndërtesës, si dhe falsitetin e kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Çështja e falsitetit të akteve ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, në gjykatat e të tria shkallëve, përfshirë edhe Gjykatën dhe aktualisht është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

3. Mbi këto rrethana faktesh, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, standardit të arsyetimit të vendimit dhe së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, i kombinuar me nenin 42 të saj, i jep drejtën individit të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues me ankesë kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtën kushtetuese individuale të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, kjo e fundit, shprehimisht, sipas nenit 42 të Kushtetutës, duhet që nga pikëpamja materiale të jetë gjykim për: i. mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues ose ligjorë të individit; ii. ose për akuzat e ngritura kundër individit. Kjo do të thotë se individi gëzon mbrojtje kushtetuese për procesin gjyqësor kur ai, cilado qoftë natyra e tij (civile, penale ose administrative), zhvillohet për të vendosur materialisht për një të drejtë/liri/interes kushtetues ose të drejtë/liri/interes ligjor. Në këto raste, në zbatim të nenit 15 të Kushtetutës (sipas të cilit të drejtat themelore qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t'i respektojnë ato dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre), gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrimin e pushtetit të tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të individëve, kanë detyrimin të respektojnë të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe të kontribuojnë në realizimin e saj dhe, në rast se ato dështojnë, atëherë është detyrë e Gjykatës, bazuar në parimin e subsidiaritetit, të gjykojë përfundimisht ankesën e individit për cenimin eventual të së drejtës kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

5. Në këtë pikëpamje, gëzimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor kushtëzohet nga identifikimi paraprak nëse individi ka materialisht një të drejtë, liri, interes kushtetues ose ligjor në hapjen e procesit gjyqësor ose jo. Ky element merr rëndësi në rrafshin kushtetues, sepse përcakton, ndër të tjera, juridiksionin material të Gjykatës, që ka të bëjë me legjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit në rastin e ankimit kushtetues individual.

6. Që një kërkues të legjitimohet *ratione materiae* për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues, duhet që e drejta e pretenduar të parashikohet dhe të mbrohet shprehimisht nga Kushtetuta, sepse çdo çështje që lidhet me juridiksionin e Gjykatës përcaktohet nga vetë Kushtetuta. Pra, si përfundim, në radhë të parë, përmbajtja e nenit 42 të Kushtetutës i përgjigjet interesit thelbësor, për të cilin zhvillohet procesi gjyqësor, në kuptimin që ai nuk ngrihet vetvetiu, por është një mjet në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të kushtetues ose të ligjshëm, në radhë të dytë, ky nen nuk mund dhe nuk duhet të marrë në mbrojtje proceset gjyqësore ku abuzohet me të drejtën.

7. Ky përfundim përputhet edhe me konceptin e gjykimit përfundimtar të ankesave të individëve që zhvillon Gjykata sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Kështu, mund të ndodhë që individi, krahas procesit kryesor për mbrojtjen e së drejtës/interesit të ligjshëm dhe në funksion të tij, mund t'i drejtohet gjykatës së zakonshme disa herë me kërkesa të veçanta procedurale, të cilat vënë në lëvizje procese të ndryshme gjyqësore, që formalisht janë të kontrollueshme me ankim deri në Gjykatën e Lartë. Në këto raste, Gjykata nuk ka pranuar ankimet, me arsyetimin se në këto raste vendimet gjyqësore nuk kanë natyrë përfundimtare në drejtim të përcaktimit të së drejtës/interesit të individit, duke e orientuar ankuesin të paraqesë ankim kur procesi kryesor, që vendos mbi të drejtën thelbësore të individit, të bëhet përfundimtar (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Duke i zbatuar këta parametra kushtetues në procesin gjyqësor ku shqyrtohet kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, është e qartë se, në parim, ky lloj procesi gjyqësor, kur përfundon me vendim mospranimi ose rrëzimi, në thelb, nuk përcakton të drejtën ose interesin e ligjshëm të individit, siç kërkohet nga neni 42 i Kushtetutës, pasi kjo e drejtë/interes është vlerësuar përfundimisht nga vendimi gjyqësor që kërkohet të rishikohet. Siç ka pohuar edhe jurisprudenca kushtetuese, kërkesa për rishikim, përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, pavarësisht pretendimeve që qëndrojnë në themel të saj, në thelb, nuk vihet në diskutim ekzistenca e së drejtës, pasi kjo e fundit ka qenë njëherë objekt i një procesi gjyqësor, në të cilin gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë shprehur me vendim përfundimtar.

9. Kjo nuk përjashton mundësinë që, në raste të veçanta, për shkak të rrethanave konkrete, individi arrin të identifikojë dhe provojë se mohimi i kërkesës për rishikim i ka cenuar atij drejtpërdrejt dhe në mënyrë reale një të drejtë kushtetuese dhe në këtë mënyrë pretendimi i tij të përbëjë lëndë për shqyrtim brenda juridiksionit të Gjykatës. Po kështu, tërësisht e kundërt paraqitet situata kur objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi gjyqësor që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto raste, e drejta kushtetuese ose ligjore e humbet cilësinë "*e përcaktuar përfundimisht në rrugë gjyqësore*" , për shkak se procesi gjyqësor i zakonshëm për të drejtën rifillon sërish dhe krijohet premisa për cenimin e parimit të sigurisë juridike, ndaj Gjykata ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e pretendimeve të tilla.

10. Duke iu kthyer çështjes konkrete, nën dritën e analizës së mësipërme, vlerësoj se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi për rrëzimin e kërkesës për rishikim, nuk ka në objektin e tij, nga pikëpamja materiale, ndonjë të drejtë kushtetuese themelore, sikurse e drejta e pronës, e cila, në thelb, ka qenë objekt mosmarrëveshjeje që i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe është zgjidhur me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011. Për më tepër, kërkuesit nuk kanë identifikuar dhe provuar ekzistencën e ndonjë rrethane të veçantë, e cila, për shkak të mohimit të kërkesës për rishikim, u ka cenuar atyre drejtpërdrejt dhe në mënyrë reale një të drejtë kushtetuese substanciale, gjë e cila do të passillte nevojën për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues. Për këtë arsye, procesi gjyqësor që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim nuk gëzon mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës.

11. Në përfundim, vlerësoj se ankimi kushtetues individual duhej rrëzuar për shkak të mungesës së juridiksionit të Gjykatës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari